

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

PËR DEPOZITIM AKTESH TË PERSONIT JURIDIK

Sot, më datë 16.06.2005, unë M. Sedo, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga Av. Ardian Kasapi, në cilësinë e perfaqësuesit të shoqërisë "SOPI" Sh.p.k., për depozitimin e vendimit të Asamblese së Ortakeve

KONSTATOVA SE:

Shoqëria "SOPI" Sh.p.k., është regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane me vendimin Nr. 4004, datë 11.05.1994, me seli në Rr. "Pjeter Bogdani", Pallati 7/1 Tirane, me Administrator Z. Lubomir Peshkatari.

Në datën 02.06.2005 Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakeve të shoqërisë "SOPI" Sh.p.k., me vendimin nr. 2, ka vendosur ndërmjet të tjerash edhe :

1. Të miratojnë raportin e Ekspertit Kontabel, Z. Artan Golemi, të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr. 4004/2 datë 31.05.2005, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me 21 882 965 leke si rezultat i shumave të disponuara në postet e fitimeve të bartura dhe fitimeve të vitit ushtrimor.
2. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë do të shoqërohet me rritjen e vlerës nominale të kuotave perkatese të çdo ortakut.
3. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë nga 100 000 leke rritet edhe me 21 882 965 leke dhe bëhet 21 982 965 leke .
4. Të miratojnë ndryshimet në nenin 7 të Aktit të Themelimit duke e riformuluar atë në këtë mënyrë :
"Kapitali themeltar i shoqërisë pas rritjes është 21 982 965 leke.
5. Të miratojnë ndryshimet në nenin 9 të Statutit duke e riformuluar atë në këtë mënyrë :
"Kapitali themeltar i shoqërisë pas rritjes bëhet 21 982 965 leke, i ndare në 100 pjesë. Vlera nominale e një pjesë është 21 982, 965 leke secila

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

VENDOSA:

2

- Pranimin e Kërkesës për depozitimin e Vendimit nr. 2 date 02.06.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqërisë "SOPI" Sh.p.k.
- Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqërisë "SOPI" Sh.p.k., I cili pas rritjes behet 21 982 965 leke, I ndare ne 100 pjese. Vlera nominale e nje pjese eshte 21 982, 965 leke secila.
- Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skeden përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

Manana Deser
[Signature]